



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 4312 / prot.

Ballsh më, 20.08.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 47 Datë 20/08 / 2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT: RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE FRATAR, BASHKIA MALLAKASTËR

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja “b”, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen e në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, VKB-së nr.52, datë 23.12.2025 “Për miratimin e financimeve të ndarë në 3-vite” si dhe projektit të hartuar nga ana e Bashkisë Mallakastër,

PROPOZOJ

I. Miratimin e projektit “Rikonstruksioni i rrugëve në Njësinë Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër, me nën segmentet si më poshtë

1.1. Rruga Bejar - Zaimaj

1.2. Rruga Ninësh – Shkëmbi i Koçit

-H. Miratimin në parim për shpronësimin / zhdëmtimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i projektit.

III. Ky projekt -vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

Konceptoi: Juristi A.Heqimaj

Pranoi : Përgj. N.Sakaj

Miratoi: Drejtor M.Shehaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE PROJEKTEVE

Nr. 4312/1 prot.

Ballsh, më 20.08 . 2026

RELACION: PËR PROJEKTIN “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE FRATAR”

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja “b”, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen e në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Mallakastër Nr. 52, datë 23.12.2025 “Për miratimin e financimit të ndarë në 3-vite”, nga ana e Bashkisë Mallakastër është hartuar projekti me objekt “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Fratar”.

Hartimi i këtij projekti vjen si pasojë e nevojës së ndërhyrjeve në infrastrukturë rrugore, për shkak të amortizimit të rrugës ekzistuese.

Projekti i këtij objekti përfshin segmentet si vijon:

- 1- Rruga Bejar-Zaimaj
- 2- Rruga Ninësh-Shkëmbi i Koçit

Realizimi i projektit për rikonstruksionin e këtyre segmenteve rrugore do të bëhet shtresë çakëlli, stabilizanti, binderi dhe asfalti. Gjithashtu për rikonstruksionin e tyre nevojiten edhe punime veprash arti si tombino si dhe punime sinjalistike si vijëzime dhe tabela.

- 1- Rikonstruksioni i rrugës Bejar-Zaimaj përfshinë segmentin sipas detajit të paraqitur në figurën nr.1. Rruga e rikonstruktuar ka gjerësi 4 m, nga të cilat 3 m janë gjerësi rruge e asfaltuar si dhe 1 m bankina anësore (2 bankina x 0.5 m).




Fig.1 Planvendosja e rrugës Bejar-Zaimaj

- 2- Rikonstruksioni i rrugës Ninësh-Shkëmbi i Koçit përfshin segmentin sipas detajit të paraqitur në figurën nr.2. Rruga e cila do të rikonstruktohet ka gjerësi 4 m, nga të cilat 3 m janë gjerësi rruge e asfaltuar si dhe 1 m bankina anësore (2 bankina x 0.5 m).



Fig.2 Planvendosja e rrugës Ninësh-Shkëmbi i Koçit

Hartoi

B.Velaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj

